

Zbubhen rreth një milion
euro të padeklaruara
në pikëkalimin kufitar
Merdar I FAQE 8



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

EDHE TETË DITË: KURTI KËRKON MARRËVESHJE NDËRPARTIAKE PËR T'I SHMANGUR ZGJEDHJET E REJA PËR PRESIDENTIN



Tri partitë më të mëdha në Kosovë, Lëvizja Vetëvendosje, Partia Demokratike e Kosovës dhe Lidhja Demokratike e Kosovës, po bisedojnë që ta zgjedhin presidentin e ri të shtetit. LV-ja kërkon marrëveshje për t'i shmangur zgjedhjet, PDK-ja thotë se nuk është pengesë e proceseve

shtetërore, por nuk mbështet kandidatura që nuk përfaqësojnë unitet qytetar. Ndërkaq LDK-ja kërkon ose marrëveshje pulitke ose konsensus për kreun e ri të shtetit. Deputetët kanë afat deri më 4 mars që ta zgjedhin presidentin e ri ose në Kosovë do të mbahen zgjedhje të reja

AKTUALE



**ARTAN GRUBI NË ARREST
SHTËPIAK F. 2**

**PESË MILIONË EURO MBËSHTETJE
PËR GRATË NDËRMARRËSE DHE
ZONAT RURALE F. 3**

**ISH-SHEFI I AKI-SË DËNOHET EDHE
NË RIGJYKIM PËR RASTIN
"GYLENISTËT" F. 7**

EKONOMI



**KU DO T'I SHPENZOJË KOSOVA
KATËR MILIARDË EURO? F. 8**

**ÇMIMET E PRODHIMIT PATËN
NGRITJE NË VITIN 2025 F. 8**

SPORT



**"DARDANET" GATI PËR NDESHJET
KUALIFIKUESE F. 11**



**SERWERI:
ISH-LUFTËTARËVE
TË UÇK-SË PO U
BËHËT PADREJTËSI
E MADHE F. 3**



**AMBASADORI
FRANCEZ: ZGJEDHJA
E PRESIDENTIT,
PËRGJEGJËSI E
PARTIVE POLITIKE F. 5**

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

ARTAN GRUBI NËN ARREST SHTËPIAK

SHKUP, 24 GUSHT - Zyra e Prokurorit Publik në Maqedoninë e Veriut ka propozuar në mbrëmjen e 23 shkurtit që ish-zëvendëskryeministri Artan Grubi t'i nënshtrohet masës së arrestit shtëpiak, pasi është arrestuar nga autoritetet maqedonase po të njëjtën ditë. Ai është arrestuar në pikën kufitare Bllacë, mes Maqedonisë së Veriut dhe Kosovës. Grubi dyshohet për abuzim të detyrës zyrtare në rastin e njohur si "Lotaria Shtetërore", rast për të cilin ka raportuar më herët edhe Radio Evropa e Lirë. Në këtë rast përfshihet edhe Përparim Bajrami, i cili po ashtu përmendet në aktakuzë si i dyshuar. Prokurorët dyshojnë se ata kanë përvetësuar rreth 8 milionë euro përmes prokurimit të pajisjeve të terminaleve të lotarisë elektronike (VLT). Prokuroria e ka arsyetuar kërkesën për arrest shtëpiak, duke thënë se shumica e të dhënave tashmë janë të siguruara, për faktin që Grubi është dorëzuar vullnetarisht para agjencive shtetërore për zbatim të ligjit, si dhe ka sinjale që "siguria e tij personale nuk mund të garantohet në një qendër ndalimi". Gjykata Themelore Penale në Shkup ka bërë të ditur se

gjyqtari i procedurës paraprake e ka pranuar propozimin për arrest shtëpiak. Ai do të jetë nën mbikëqyrje 24-orëshe nga zyrtarë të Ministrisë së Brendshme. Grubi është arrestuar pas më shumë se një viti prej kur ishte në arrati. Autoritetet kanë thënë se ai është në gjendje të mirë shëndetësore dhe që është marrë në pyetje nga Zyra e Prokurorit Publik. Prokuroria pati kërkuar ndalimin e Grubit dhe Bajramit, me arsyetim se ekziston dyshim i bazuar se veprimet e të dyve kanë pasur qëllim përfitimin e paligjshëm material. Më 17 dhjetor të vitit të kaluar, Prokuroria Penale pati kërkuar paraburgim prej 30 ditësh për Grubin dhe Bajramin dhe po atë ditë autoritetet maqedonase patën lëshuar urdhërarrestim ndërkombëtar për të dyja figurat. Artan Grubi pati thënë përmes një postimi në "Facebook" se nuk po arratiset mirëpo që ishte në një vizitë private në Kosovë dhe që do të kthehej në shtëpi. Ditën pas asaj deklarate, policia ka kërkuar në dy lokacione mirëpo nuk e ka gjetur atë. Më pak se një muaj para se të jepte dorëheqje nga pozita e prokurorit të shtetit, Lupçe Kocovski ka thënë se hetimet



për rastin e Lotarisë Shtetërore tashmë kanë përfunduar dhe pritet vetëm ekstradimi. Ikja e tij ka qenë pengesë për nisje të gjykimit. Për dallim prej Grubit, i cili gjatë periudhës së arratisë kishte dyshime se po fshihej në Kosovë ose Shqipëri, avokati i Bajramit ka thënë më parë se klienti i tij nuk ka ikur, por ka jetuar jashtë Maqedonisë së Veriut disa muaj para se t'i bastisej shtëpia. Kryeministri maqedonas, Hristjan Mickoski pati thënë atëbotë se Grubi "bashkë me

një person tjetër, biznesmen, është larguar nga Maqedonia [e Veriut] me makinë me targa diplomatike dhe është nisur drejt vendit fqinj Kosovës" dhe që Bajrami, sipas tij, nuk ka qenë brenda territorit maqedonas për kohë të gjatë. Grubi është futur në listën e zezë të Departamentit amerikan të Shtetit më 9 dhjetor, për shkak të, siç është thënë, përfshirjes në korrupsion, për ndërhyrje politike dhe përpjekje për të mashtruar gjyqësorin. Arsyetimi për përfshirje në këtë

listë ishte sepse ata kanë marrë rryshfet për të ndikuar në procedurat gjyqësore që lidhen me dënimin penal të ish-drejtorit të Administratës së Sigurisë dhe Kundërzbulimit (DSK), Sasho Mijalkov, në rastin "Target" të hapur nga Prokuroria Speciale Publike (PSP), i cili kishte të bënte me përgjimet masive. Grubi ishte anëtar i Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI) të opozitës, dikur deputet dhe zëvendëskryeministër në Qeverinë e mëparshme të LSDM-së dhe BDI-së.

STUDENTËT IRANIANË PROTESTOJNË KUNDËR QEVERISË

Tehran, 24 shkurt- Për të tretën ditë me radhë, studentët iranianë kanë organizuar protesta antiqeveritare në disa universitete, sipas videove të publikuara online, që janë verifikuar nga Radio Evropa e Lirë. Protestat e reja janë të parat që kur autoritetet vranë mijëra njerëz gjatë shtypjes së paprecedent të protestave mbarëkombëtare kundër regjimit klerikal të Iranit muajin e kaluar. Trazirat e reja vijnë në kohën kur Irani po përballlet me mundësinë e një veprimi ushtarak nga Shtetet e Bashkuara. Presidenti amerikan, Donald Trump, ka paralajmëruar Teheranin kundër dhunës së mëtejme ndaj protestuesve dhe ka kërcënuar se do ta godasë Republikën Islamike për shkak të refuzimit të saj që të heqë dorë nga programi bërthamor. Dhjetëra studentë zhvilluan protesta më 23 shkurt në të paktën katër universitete në kryeqytetin iranian, Teheran, përfshirë Universitetin Al-Zahra, Universitetin e Teheranit, Universitetin e Teknologjisë Sharif dhe Universitetin e Teknologjisë Amir Kabir. Video në rrjetet sociale shfaqën studentet në Universitetin Al-Zahra duke brohoritur: "Ky është



viti i gjakut. Sayed Ali do të rrëzohet", duke iu referuar liderit suprem ajatollah Ali Khamenei. Ndërkaq, video të tjera shfaqën studentë në Universitetin e Teheranit duke brohoritur: "Grua, jetë, liri", një referencë për protestat mbarëkombëtare të vitit 2022, që u nxitën nga vdekja e një gruaje të re në paraburgim, e cila akuzohej nga autoritetet iraniane se kishte shkelur ligjin për hixhabin. Protestat e reja përkojnë me

fillimin e semestrit të ri universitar dhe me qindra ceremoni që janë mbajtur në të gjithë vendin gjatë javës së kaluar për të përkujtuar viktimat e vrara gjatë shtypjes së protestave masive në janar. Sipas grupeve për të drejtat e njeriut, të paktën 7.000 persona u vranë gjatë protestave që shpërthyen në fund të dhjetorit të vitit 2025, edhe pse besohet se numri real i të vdekurve është shumë më i lartë. Shumica e vrasjeve raportohet se

ndodhën midis 8 dhe 10 janarit, kur konsiderohet se ishte kulmi i shtypjes. Këto protesta ishin ndër më të mëdhatë në Iran që nga Revolucioni Islamik i vitit 1979. Protestat e reja në Teheran po zhvillohen teksa ShBA-ja vazhdon të kërcënojë me sulme Iranin për shkak të programit të tij të kontestuar bërthamor, pavarësisht disa rundesh të negociatave indirekte. Trump ka dërguar në rajon dy

aeroplanmbajtës me avionë luftarakë dhe bombardues, si dhe forca mbështetëse janë parë duke fluturuar drejt bazave ajrore në Lindjen e Mesme. Në shfaqjen më të madhe të raportuar të kundërshtimit në kryeqytet që nga shtypja vdekjeprurëse e muajit të kaluar, studentët iranianë duke brohoritur slogane antiqeveritare u përballën me forcat e sigurisë jashtë Universitetit të Teknologjisë Sharif më 21 shkurt. Tubime të ngjashme u raportuan edhe në universitete të tjera. Më 22 shkurt, studentët u përballën me ushtarë nga Basiji, një forcë vullnetare paramilitare që ka luajtur një rol të rëndësishëm në shtypjen e protestave politike në të kaluarën, jashtë Universitetit të Teknologjisë Amir Kabir. Studentët dëgjoheshin duke brohoritur slogane antiqeveritare, sipas videove të publikuara në rrjetet sociale. Të tjerë u panë duke valëvitur flamurin kombëtar iranian. Universitetet në Teheran shpesh kanë qenë skenë e protestave studentore që kanë ndodhur që nga revolucioni i vitit 1979, dhe që kanë rezultuar në shtypje brutale nga forcat e sigurisë.

Kurti: Normalizimi me Serbinë vetëm përmes njohjes reciproke

Prishtinë, 24 shkurt - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka pritur në takim përfaqësuesin e Posaçëm të Bashkimit Evropian për Dialogun Kosovë - Serbi, Peter Sorensen. Emisari Sorensen e uroi kryeministrin me rastin e

formimit të qeverisë së re dhe për mandatin e tij të ri. Në takim u diskutua për zhvillimet e fundit në vend, për sundim të ligjit dhe përparimin e Kosovës në procesin e integritetit evropian, si prioritete të qarta të agjendës sonë

qeverisë dhe për procesin e dialogut të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian. Qeveria e Republikës së Kosovës mbetet e përkushtuar për normalizim të plotë të marrëdhënieve me Serbinë me njohje reciproke.



SERWER: ISH-LUFTËTARËVE TË UÇK-së PO U BËHET PADREJTËSI E MADHE

Prishtinë, 24 shkurt - Krijimi i Gjykatës Speciale në Hagë ishte një gabim i madh. Kështu thotë eksperti amerikan dhe njohësi i çështjeve të Ballkanit Perëndimor, Daniel Serwer. Ai e quajti padrejtësi të madhe atë që po u bëhet ish-luftëtarëve të Ushtria Çlirimtare e Kosovës, duke akuzuar Dhomat e Specializuara për tejkallim të mandatit. “Unë e shikoj si kthimin e viktimës në dhunues dhe jam shumë i zhgënjyer me gjykatën. Mori një interpretim të gjerë të mandatit të vet. Kjo nuk më pëlqen aspak dhe po del si një gabim i madh që unë i kam nxitur politikanët në Kosovë që ta zbatojnë, por



tashmë po del gabim i madh. E ka tejkalluar masën, e ka vënë gjykatën në një kanalizim që

do të përfundojë në diskreditimin e gjyqit dhe jo të UÇK-së”, tha eksperti

amerikan në një intervistë për A2 CNN, transmeton Klankosova.tv.

Serwer foli gjithashtu për Bordin e Paqes, duke e cilësuar atë një ide të keqe. Megjithatë, sipas tij, Kosova dhe Shqipëria përfitojnë. “Bordi i Paqes, nuk është diçka që unë jam entuziast me thënë të drejtën dhe mendoj se ishte një gabim që u autorizua edhe nga Këshilli i Sigurimit pa pasur një mandat të qartë dhe kjo pjesëmarrje është e dyshimtë përballë syrit të evropianëve dhe nuk jam optimist. Mendoj se kjo është në thelb një ide jo e mirë, por nuk do të thotë se Kosova të mos marrë avantazh dhe të mos e rrisë profilin ndërkombëtar. Mendoj se Kosova dhe Shqipëria po e bëjnë këtë”, tha Serwer.

5 MILIONË EURO MBËSHTETJE PËR GRATË NDËRMARRËSE DHE ZONAT RURALE



Prishtinë, 24 shkurt - Ambasadori i Francës në Kosovë, Olivier Guerot, ka marrë pjesë të martën në ceremoninë e nënshkrimit të marrëveshjes për financim

prej 5 milionë eurosh ndërmjet Proparco - degë e grupit të Agjencisë Franceze për Zhvillim (AFD) dhe Agjencionin për Financim në Kosovë (AFK).

Ky financim synon të zgjerojë qasjen në shërbime financiare të kategorive më pak të përfshira, veçanërisht gratë ndërmarrëse (3 milionë euro) dhe komunitetet rurale (2

milionë euro). Ky instrument do të kontribuojë në promovimin e përfshirjes financiare dhe uljen e pabarazive ekonomike përmes uljes së pabarazive

socio-ekonomike: përfshirja financiare e familjeve me të ardhura të ulëta, zvogëlimi të pabarazive territoriale dhe zvogëlimi të pabarazive gjinore.

Arlind Manxhuka emërohet zëdhënës i Qeverisë së Kosovës

Prishtinë, 24 shkurt - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka emëruar Arlind

Manxhukën zëdhënës të Qeverisë së Kosovës. Manxhuka do të jetë edhe

këshilltar politik i kryeministrit. Deri më tani zëdhënës i Qeverisë së Kosovës ishte Përparim

Kryeziu, i cili së fundi u emërua në pozitën e zëvendësministrit të Arsimit dhe Shkencës.





EDHE TETË DITË: KURTI KËRKON MARRËVESHJE NDËRPARTIAKE PËR T'I SHMANGUR ZGJEDHJET E REJA PËR PRESIDENTIN

Tri partitë më të mëdha në Kosovë, Lëvizja Vetëvendosje, Partia Demokratike e Kosovës dhe Lidhja Demokratike e Kosovës, po bisedojnë që ta zgjedhin presidentin e ri të shtetit. LV-ja kërkon marrëveshje për t'i shmangur zgjedhjet, PDK-ja thotë se nuk është pengesë e proceseve shtetërore, por nuk mbështet kandidatura që nuk përfaqësojnë unitet qytetar. Ndërkaq LDK-ja kërkon ose marrëveshje pulitke ose konsensus për kreun e ri të shtetit. Deputetët kanë afat deri më 4 mars që ta zgjedhin presidentin e ri ose në Kosovë do të mbahen zgjedhje të reja

PRISHTINË, 24 SHKURT - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, njëherësh udhëheqës i Lëvizjes Vetëvendosje, tha se situata rreth zgjedhjes së presidentit të ri të shtetit “nuk është e lehtë”, por theksoi se do të përpiqen me dy partitë e tjera të mëdha shqiptare që t'i shmangin zgjedhjet e reja. Presidentes aktuale të Kosovës, Vjosa Osmani, i skadon mandati më 4 prill dhe afati i fundit për votimin e figurës që do ta ketë mandatin e ri është 4 marsi. Osmani e ka bërë të qartë se synon edhe një mandat. Nëse deputetët nuk arrijnë ta

zgjedhin kreun e ri të shtetit, atëherë zgjedhjet e reja do të mbahen në prill, tha Kurti. “Do të përpiqemi maksimalisht që t'i evitojmë zgjedhjet për shkak të moszgjedhjes së presidentit”, tha Kurti. Ai këto deklarata i bëri një ditë parë, pas një takimi që zhvilloi me kreun e Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku. Kurti theksoi se as partia e tij, as LDK-ja dhe as Partia Demokratike e Kosovës nuk kanë një kandidat për presidentin. “Pra, ne si parti nuk kemi pasur kandidat nga radhët tona andaj në vijim ose duhet ta gjejmë një emër të

përveçëm që na garanton së paku dy të tretat e deputetëve që qëndrojnë në sallë dhe votojnë duke zgjedhur një emër të përveçëm në fletëvotim që e hedhin në kuti, më së largu më 4 mars. Ose është tjera, që subjektet politike merren vesh për rrugën përpara”, tha ai. I pyetur nëse e përkrah Vjosa Osmanin për rizgjedhje, Kurti u përgjigj: “Ne nuk kemi mbledhur nënshkrime për askënd për shkak se edhe në rast se i mbledhim nënshkrimet, po theksoj, ne në rastin më të mirë teorik mund të mbërrijmë te numri 66, që është aq larg numrit 80.

Prandaj, kot ne mund të nxjerrim kandidat, ndërkohë që dy subjektet e tjera thanë se nuk i kemi as 30 nënshkrime sepse 30 është minimumi për propozimin”, tha Kurti, duke shtuar se do të ishte e “dëmshme” që tani LV-ja të dalë me një kandidat pasi ka vetëm 66 vota. Sipas tij, me votat aktuale që ka partia e tij dhe partnerët nga komunitetet joserbe, mund të mblidhen nënshkrime për dy kandidatë për president. Por, Kurti insistoi se për zgjedhjen e presidentit nuk duhet të synohet vetëm pragu i 80 votave, por deri në 85, në mënyrë që procesi të mos dështojë nëse ndonjë deputet mungon. Kurti, po ashtu, konfirmoi se një natë më parë është takuar në Prekaz me Rifat Jasharin, me të cilin tha se ka biseduar për zhvillimet politike dhe shumë çështje të tjera. “Mirëpo, zgjidhja është mes tri subjekteve politike”, vazhdoi

ai. Në të kaluarën janë përmendur emra nga familja e heroit të Kosovës, Adem Jashari, si kandidatë të mundshëm për president, por propozimet nuk janë jetësuar asnjëherë. Megjithatë, Kurti tha se e bën optimist konstruktiviteti i takimeve për arritjen e një marrëveshjeje me partitë e tjera për çështjen e presidentit. “Nuk shoh zell për zgjedhje të reja dhe kjo është një e përbashkët që kemi. Këto elemente më bëjnë optimist”, tha ai për medie. Kreu i LDK-së, Lumir Abdixhiku, tha se nevojitet konsensus politik apo marrëveshje mes partive për emrin. “Dakordimi i përgjithshëm është se janë vetëm dy rrugë përpara. E para është ose duhet konsensus politik mes faktorëve të vendit dhe ky konsensus duhet të ndërtohet në këto nëntë ditë e ardhshme ose duhet një marrëveshje klasike politike

Zbulohen rreth një milion euro të padeklaruara në pikëkalimin kufitar Merdar

PRISHTINË, 24 SHKURT - Në pikëkalimin kufitar Merdar zyrtarët e Doganës së Kosovës kanë selektuar një automjet për kontroll në hyrje të territorit të Republikës së Kosovës, bazuar në analizën e riskut dhe procedurat standarde operative. Automjeti fillimisht është kontrolluar përmes pajisjes së skanimit me rreze X (X-Ray), ku janë identifikuar indikacionet e para për ekzistimin e një hapësire të dyshimtë të modifikuar në dyshemenë e tij. Pas këtyre

indikacioneve, Dogana e Kosovës ka kërkuar asistencë nga zyrtarët e Policisë Kufitare, të cilët kanë ofruar mbështetje teknike përmes pajisjes fibroskopike. Gjatë kontrollit të përbashkët, dyshimet e ngritura nga skaneri janë konfirmuar me zbulimin e mjeteve monetare të padeklaruara, të fshehura në një hapësirë të improvizuar brenda automjetit. Sipas vlerësimeve fillestare, shuma e mjeteve monetare dyshohet të jetë rreth 1 000

000 (një milion) euro. Njësitë hetimore të Doganës kanë dalë menjëherë në vendin e ngjarjes. Prokurori kompetent është njoftuar dhe, në koordinim me të, po ndërmerren veprime të mëtejme hetimore në përputhje me autorizimet ligjore. Dogana e Kosovës thekson se përdorimi i teknologjisë së avancuar të kontrollit, si skanerët X-Ray, mbetet një nga mjetet kyçe për zbulimin e rasteve të kontrabandës dhe parandalimin e veprimtarive të kundërligjshme financiare.



mes partive për çështjen e presidentit. Në të dyja rastet duhen së paku dy të tretat e votave të deputetëve. Mbeti që të takohemi në ditët në vijim për të parë mundësi që kemi përpara”, tha ai. I pyetur nëse është diskutuar për emra konkretë që do të mund të zgjidheshin president, përfshirë emrin e presidentes aktuale, Abdixhiku tha se fillimisht është procesi i arritjes së një konsensusi e më pas vijnë emrat. Çështjen e presidentit Kurti e ka diskutuar të dielën edhe me kryetarin e Partisë Demokratike të Kosovës, Bedri Hamza. Ky i fundit ka thënë se zgjedhja e presidentit nuk është çështje vetëm e një partie, por e të gjithë neve si përfaqësues të zgjedhur të popullit. Në këtë drejtim ai ka thënë se për këtë arsye iu përgjigj pozitivisht ftesës së Kurtit për të diskutuar për zhvillimet politike dhe procesin e zgjedhjes së presidentit të ri të vendit. “Si subjekt politik opozitar nuk kemi qenë dhe nuk jemi pengesë e proceseve shtetërore, por as nuk mbështesim kandidatura që nuk përfaqësojnë unitetin qytetar sipas frymës kushtetuese. Uroj që të ketë reflektim nga ata që e kanë përgjegjësinë kushtetuese për të propozuar kandidatura me mbështetje të gjerë, duke shmangur kalkulimet

afatshkurtra partiake. Stabiliteti institucional është jetik dhe duhet të trajtohet si i tillë. Për ne interesi shtetëror është mbi çdo kalkulim politik dhe këtë standard e mbrojmë me vendosmëri”, ka thënë Hamza pas takimit. Partitë e tjera nuk kanë përmendur deri më tani një kundërkandidat. Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka thënë se do ta shqyrtonte këtë pozitë nëse partitë e tjera opozitare do të kishin disponim mirëpo, sipas tij, ato kanë qenë të paimteresuara. Si opsion për president po përmendet edhe dikush nga familja Jashari, por ende nuk ka diçka zyrtare. Për secilën kandidaturë duhet të sigurohen të paktën 30 nënshkrime të deputetëve. Kurti i ka 57 ulëse në Kuvendin e Kosovës, ndërsa për zgjedhjen e presidentit duhen të paktën 80 vota prej 120 në total. Nëse në dy raundet e para të votimit një kandidat nuk i siguron 80 vota, atëherë në votimin e tretë mjafton t'i ketë 61 sosh. Pavarësisht prej rolit ceremonial presidencial, mospërmbushja e afateve i kushton shtetit. Nëse Kosova nuk e ka emrin e ri për pozitën e presidentit deri më 4 mars, atëherë duhet t'i organizojë zgjedhjet e reja parlamentare brenda 45 ditësh.

AMBASADORI FRANCEZ: ZGJEDHJA E PRESIDENTIT, PËRGJEGJËSI E PARTIVE POLITIKE NË KOSOVË

PRISHTINË, 24 SHKURT - Ambasadori i Francës në Kosovë, Olivier Guerot, ka deklaruar se është çështje e partive politike ta gjejnë mënyrën e duhur për zgjedhjen e presidentit. Ai për “KosovaPress” u shpreh se i sheh si hapa pozitivë takime e fundit që janë zhvilluar në mes të partisë në pushtet, Lëvizja Vetëvendosje dhe dy partive më të mëdha opozitare, Partisë Demokratike e Kosovës dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës, lidhur me zgjedhjen e presidentit. Guerot theksoi se edhe Kushtetuta e Kosovës e bën të nevojshme që partitë politike të bisedojnë me njëra-tjetrën. “Mendoj se është shumë mirë që partitë politike po flasin me njëra-tjetrën. Është e tyre që të gjejnë një zgjidhje. Kuadri institucional i Kushtetutës së Kosovës e bën të nevojshme që partitë politike të bisedojnë me njëra-tjetrën. Sigurisht, nuk dua të komentoj për këto diskutime tani sepse është çështje e tyre që ta gjejnë mënyrën e duhur për zgjedhjen e presidentit”, u shpreh ambasadori francez.



Ambasadori francez beson se subjektet politike dhe institucionet në Kosovë qetësisht do të punojnë për zgjedhjen e shefit të shtetit. I pyetur për një emër konsensual për president, ambasadori francez deklaroi se nuk dëshiron ta komentojë politikën e brendshme, por

shprehi lumturi që institucionet po funksionojnë. Guerot është shprehur i lumtur që pas një viti Kosova ka themeluar institucionet. Deri më 4 mars presidenti i Kosovës duhet të zgjedhet në Kuvendin e Kosovës, ndryshe vendi shkon në zgjedhje të parakohshme.

Petrut Selimi: Gjykata Speciale ka dëmtuar kredibilitetin e Perëndimit në mënyrë të pakthyeshme

PRISHTINË, 24 SHKURT - Ish-kryediplomati i Kosovës, Petrit Selimi, ka shkruar rreth historikut të krijimit të Gjykatës Speciale dhe presionit të madh ndërkombëtar që ekzistonte atë kohë. Selimi në një postim në “X” ka thënë se përgjatë kësaj kohe janë shpenzuar miliarda dollarë për Specialen dhe, sipas tij, asnjë

diplomat që e ka takuar, evropian apo amerikan, nuk është krenar në rolin e luajtur për krijimin e Speciales. “Secili prej tyre shpreh keqardhje dhe po, turp”, ka shkruar Selimi. Sipas tij, Specialja e ka dëmtuar në mënyrë të pakthyeshme besueshmërinë e Perëndimit në Kosovë. “Gjyqtarët do të duhet ta lirojnë Thaçin nga akuzat.

Dëshmitarë të shquar të mbrojtjes dhe avokatët e udhëheqësve të UÇK-së sollën prova më se të mjaftueshme për të krijuar dyshime më shumë se të arsyeshme mbi çështjen e prokurorisë. Por dëmi i shkaktuar besueshmërisë perëndimore në Kosovë është i pariparueshëm”, ka shkruar Selimi.



Policia pranon donacion nga Gjermania pesë vetura dhe pajisje teknologjike

PRISHTINË, 24 SHKURT - Zëvendësdirigjenti i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Fehmi Hoti, me bashkëpunëtorë, ka pritur në takim përfaqësuesin e Ambasadës së Gjermanisë, zëvendësambasadorin Christian

Bottcher, me ç'rast është bërë pranim-dorëzimi i një donacioni nga Republika Federale e Gjermanisë. Ky donacion synon mbështetjen për Policinë e Kosovës, konkretisht në

forcimin e mbikëqyrjes së kufirit shtetëror. Donacioni në fjalë ka vlerë rreth 200 mijë euro, përfshirë pesë vetura dhe pajisje teknologjike. Policia e Kosovës vlerëson

lart bashkëpunimin dhe përkrahjen e vazhdueshme të Qeverisë së Gjermanisë dhe Ambasadës së Gjermanisë për ngritjen e kapaciteteve logjistike dhe të teknologjisë.



DIGJITALIZIMI I ARSIMIT NUK ËSHTË THJESHT NJË TREND, ËSHTË DOMOSDOSHMËRI PËR NJË ARSIM CILËSOR

PRISHTINË, 24 SHKURT - Në sallën e Kuvendit Komunal, Drejtoria Komonale e Arsimit në Prishtinë ka zhvilluar një punëtori të rëndësishme me drejtorët e të gjitha shkollave fillore, si dhe me psikologë e pedagogë, për zhvillimin dhe avancimin e kurrikulës digjitale SchoolMe. Nën udhëheqjen e drejtorit Samir Shahimi u riafirmua përkushtimi i DKA-së për ta bërë kurrikulën digjitale pjesë të natyrshme të çdo dite mësimore jo thjesht si një platformë shtesë, por si një

mjet funksional që lehtëson planifikimin, organizimin, vlerësimin dhe komunikimin brenda shkollës. Diskutimi ishte i hapur, konstruktiv dhe me energji pozitive, duke u fokusuar në rritjen e përdorimit të platformës në çdo shkollë, thjeshtimin dhe praktikitetin për mësimdhënësit, shtimin e funksioneve të reja sipas nevojave reale dhe përmirësimin apo eliminimin e elementeve që nuk kontribuojnë në efikasitet. DKA e Prishtinës beson



fuqishëm se zhvillimi i suksesshëm i kësaj platforme vjen përmes bashkëpunimit të drejtpërdrejtë me shkollat. Zëri i drejtorëve, pedagogëve dhe psikologëve është thelbësor për ta ndërtuar një sistem digjital që i shërben realisht procesit mësimor. "Digjitalizimi i arsimit nuk është thjesht një trend, është një domosdoshmëri për një arsim cilësor dhe bashkëkohor. Prishtina po e udhëheq këtë proces me vizion, përgjegjësi dhe bashkëpunim", është theksuar në këtë takim.

OSMANI PRANOI LETRAT KREDENCIALE TË AMBASADORES SË RE TË KOSTA RIKËS NË KOSOVË



PRISHTINË, 24 SHKURT - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pranuar letrat kredenciale të ambasadores së re të Republikës së Kosta Rikës në Republikën e Kosovës, Olga M. Sauma Uribe. Me këtë rast, Osmani i uroi mirëseardhje ambasadores dhe e përgëzoi për emërimin, duke shprehur bindjen se mandati i ambasadores do të kontribuojë në

thellimin e mëtejshmë të marrëdhënieve të shkëlqyera ndërmjet dy vendeve. Presidentja shprehu mirënjohje për mbështetjen e hershme dhe parimore të Kosta Rikës për pavarësinë dhe sovranitetin e Republikës së Kosovës, duke theksuar potencialin për zgjerimin e bashkëpunimit dypalësh. Ajo vuri në pah se Kosova i vlerëson

lart marrëdhëniet miqësore me shtetet e Amerikës Latine dhe mbetet e përkushtuar për forcimin e bashkëpunimit me vendet e këtij rajoni në fusha me interes të ndërsjellë. Gjatë takimit u diskutua për mundësitë e thellimit të bashkëpunimit në diplomaci, ekonomi dhe veçanërisht në turizëm.

EMËROHEN DREJTORËT E RINJ TË KOMUNËS SË GJILANIT

GJILAN, 24 SHKURT - Komuna e Gjilanit ka emëruar drejtorët e rinj në mbledhjen e parë të bordit të drejtorëve. Në ditët e ardhshme pritet të emërohet edhe drejtori ose drejtoresha e Arsimit dhe zyrtarët e tjerë. Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, tha se në këtë mbledhje po prezantojnë një pjesë të përbërjes së re të kabinetit qeverisës për komunën e Gjilanit. "Zotohemi se kjo përbërje do të jetë e përkushtuar dhe transparente që gjatë 4 viteve të ardhshme të punojë me nder dhe përgjegjësi", tha Alban Hyseni. I pari Gjilanit, tregoi përbërjen e kabinetit qeverisës: Kushtrim Ibrahim - drejtor i Shërbimeve Publike; Bajram Isufi - drejtor për

Bujqësi dhe Pylltari; Flakron Rexhepi - drejtor për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit; Mimoza Kadriu - drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale; Kushtrim Zeqiri - drejtor për Kulturë, Rini dhe Sport; Enver Shabani - drejtor për Mbrojtje dhe Shpëtim; Eljesa Rashiti - drejtoreshë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë; Avdyll Kastrati - drejtor për Buxhet dhe Financa; Haki Huruglica - drejtor për Zhvillim Ekonomik; Isa Agushi - drejtor për Inspeksion; Elbasan Shabani - drejtor për Administratë të Përgjithshme. Ditëve në vijim do t'i bëjmë me dije edhe emrat e zyrtarëve të tjerë. Na priftë e mbara", tha kryetari Hyseni.



Kurti emëron zëvendësministër të Arsimit ish-zëdhënësin e qeverisë, Përparim Kryeziun

PRISHTINË, 24 SHKURT - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka emëruar Përparim Kryeziun në

pozitën e zëvendësministrit të parë të Arsimit dhe Shkencës. Gjatë mandatit të kaluar

Përparim Kryeziu ka mbajtur pozitën e zëdhënësit të qeverisë. Kryeministri Kurti e uroi

Kryeziun për detyrën e re dhe i dëshiroi suksese në përmbushjen e përgjegjësisë së reja.



Osmani pret në takim lamtumirës komandantin amerikan: Prania e ShBA-së në kuadër të KFOR-it, jetike për Kosovën

PRISHTINË, 24 SHKURT - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur në takim lamtumirës komandantin në largim të Komandës Rajonale Lindje të KFOR, kolonelin Jonathan Lloyd nga Garda Kombëtare e Louisianës, si dhe pasuesin e tij, kolonelin Sam Sargeant. Gjatë takimit presidentja

Osmani e falënderoi kolonelin Lloyd për shërbimin dhe përkushtimin e tij gjatë mandatit në Kosovë, duke vlerësuar lart kontributin në forcimin e sigurisë dhe stabilitetit në vend dhe rajon. Në shenjë mirënjohjeje, ajo i ndau atij një mirënjohje për angazhimin e çmuar. Më tej presidentja Osmani i

uroi mirëseardhje kolonelit Sargeant, duke e siguruar për mbështetjen e plotë të institucioneve të Kosovës në përmbushjen e mandatit të tij dhe të misionit të KFOR-it të udhëhequr nga NATO. Presidentja Osmani shprehu mirënjohjen e thellë, në emër të popullit të Kosovës, për vazhdimin e pranisë së



Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara në vend si pjesë e misionit të KFOR-it, e cila është jetike për paqen, sigurinë dhe stabilitetin në Kosovë dhe rajon. Në këtë

kontekst, presidentja theksoi se Kosova do të mbetet gjithmonë mirënjohëse ndaj Shteteve të Bashkuara për mbështetjen e palëkundur në të gjitha etapat.

ISH-SHEFI I AKI-SË DËNOHET EDHE NË RIGJYKIM PËR RASTIN “GYLENISTËT”

PRISHTINË, 24 SHKURT - Gjykata Themelore në Prishtinë e ka shpallur fajtor edhe në rigjykim ish-shefin e Agjencisë Kosovare për Inteligjencë (AKI), Driton Gashi dhe e ka dënuar me katër vjet e tetë muaj burgim në rastin e njohur “Gylenistët”, sipas “Betimit për Drejtësi”. Ndaj tij është shqiptuar edhe një dënim plotësues: ndalim i ushtrimit të funksionit në administratë publike për katër vjet pas përfundimit të dënimit me burgim. Gashi ishte dënuar me masë të njëjtë burgimi - katër vjet e tetë muaj - edhe në korrik të vitit 2023 për dënim të paligjshëm të gjashtë shtetasve të Turqisë që kishin leje qëndrimi dhe leje pune në Kosovë. Vendimi në procedurën e rigjykit është shpallur nga kryetarja e trupit gjyqës, Violeta Namani-Hajra dhe anëtarët

Medie Bytyqi dhe Leon Përlaska. Gashi është raportuar se nuk ka qenë i pranishëm në seancë, por vetëm mbrojtësi i tij, avokati Driton Musliu. Në aktakuzën e ngritur nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës thuhej se Gashi ka keqpërdorur detyrën zyrtare duke mos i përmbushur detyrat sipas kompetencës, duke rekomanduar revokimin e lejeve të qëndrimit dhe mosdhënien e lejes për njërin prej tyre, “për arsye se kinse ata paraqesin rrezik për sigurinë kombëtare, fakt që nuk është provuar fare në procedurë të zbatuar në bazë të ligjit”. Në shpalljen e vendimit më 2023, nga akuza ishin liruar ish-drejtori i Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migracion në Ministrinë e Punëve të Brendshme, Valon Ramadani, dhe ish-drejtori i Drejtorisë për Migracion dhe të Huaj në kuadër të Policisë



Kufitare, Rrahman Sylejmani. Aktakuza u ngrit pasi më 29 mars të vitit 2018, pas një aksioni të gjerë të Policisë së Kosovës dhe Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, i cili rezultoi me arrestimin e gjashtë shtetasve turq. Dëbimi i tyre është thënë të jetë bërë përmes një aksioni të koordinuar ndërmjet shërbimeve të inteligjencës nga Turqia dhe Kosova. Arrestimi dhe dëbimi i parapriu revokimi i lejeve të tyre të

qëndrimit, për të cilin veprim më vonë gjykata tha se ishte i jashtëligjshëm. Nga pesë shtetasit turq, tre prej tyre posedonin leje të përhershme të qëndrimit, përkatësisht Mustafa Erdem, Yusuf Karabina, Karhaman Demirez, ndërsa dy prej tyre Hasan Hysein Demir dhe Cihan Ozkan kishin leje të përkohshme. Familjet e gjashtë shtetasve turq ngritën një padi ndaj institucioneve të Kosovës në vitin 2018 për arrestim dhe ndalim arbitrar të familjarëve të tyre. Disa nga familjarët kanë kërkuar azil në Kosovë e disa të tjerë janë larguar drejt vendeve evropiane. Gjashtë shtetasit turq të arrestuar në Kosovë dhe të dëbuar në Turqi në mars të vitit 2018 u dënuan nga gjykatat atje me gjithsej 56 vjet dhe 7 muaj e gjysmë burgim. Gjykatat në Turqi, shumicës prej tyre iu shqiptuan nga 8 vjet

burgim, kurse njërit, Mustafa Erdem, drejtor i përgjithshëm i institucionit “Gulistan” në Kosovë, më 5 qershor iu shqiptua dënimi prej 15 vjetësh. Shkollat “Mehmet Akif” në Kosovë i përkasin Institucionit Arsimor “Gulistan”. “Gulistan” ka kopshte, institucione parashkollore, shkolla fillore dhe të mesme në gjithë Kosovën. Besohet se ato janë të frymëzuara nga Lëvizja Hizmet e klerikut fetar turk Fethullah Gulen, të cilin presidenti i Turqisë, Recep Tayyip Erdogan, e fajëson për orkestrimin e përpjekjes për grushtshtet në Turqi në vitin 2016. Mbështetësit e Gulenit, i cili vdiq në tetor të vitit 2024, konsiderohen terroristë nga Turqia, ndërkaj Lëvizja Hizmet, që ka miliona mbështetës, në Turqi është shpallur terroriste.

GOLA ME DELEGACIONIN E BE-SË: KUVENDI KA NJË AGJENDË TË QARTË REFORMASH NË PROCESET INTEGRUESE

PRISHTINË, 24 SHKURT - Nënkrjetari i Parë i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Ardian Gola, ka pritur të martën në takim një delegacion të Bashkimit Evropian, të përbërë nga Zuzana Michalcová Šutiaková, shefe për Ballkanin Perëndimor në EEAS, si dhe përfaqësues të Zyrës së BE-së në Kosovë: Eva Palatova, Blerta Bejtullahu dhe Felix Rathje. Gjatë takimit u diskutua për zhvillimet e fundit institucionale në vend, konstituimin e

legjislaturës së 10 të Kuvendit si dhe ritmin e vendimmarrjes në javët e para të punës. Nënkrjetari Gola theksoi se institucionet e Republikës së Kosovës janë plotësisht funksionale dhe të përkushtuara ndaj një agjende të qartë reformash dhe integrimi evropian. Në këtë frymë, si një ndër vendimet e para të kësaj legjislature, Kuvendi miratoi Marrëveshjen për Planin e Rritjes të Bashkimit Evropian, nga i cili Kosova përfiton 882.6



milione euro, duke reflektuar orientimin e palëkundur evropian dhe gatishmërinë për të avancuar me reforma

konkrete. Po ashtu, u veçua miratimi i marrëveshjeve me Bankën Botërore në vlerë prej 120 milionë eurosh, si dhe miratimi i Buxhetit për vitin 2026 në vlerë 4 miliardë euro, buxheti më i madh në historinë e vendit. Në fund të takimit u diskutua edhe për rolin e komuniteteve joshumicë në Kuvend dhe për përfshirjen e tyre aktive në jetën institucionale. U theksua se Kosova ka ndërtuar një model të avancuar për garantimin e të

drejtave të komuniteteve, duke qenë ndër vendet me standardet më të larta në Evropë në këtë drejtim. Nënkrjetari Gola shprehu mirënjohje për mbështetjen e Bashkimit Evropian gjatë periudhës së krizës politike të vitit të kaluar, duke theksuar se Kuvendi i Kosovës mbetet i përkushtuar për thellimin e bashkëpunimit dhe për avancimin e reformave që e afrojnë vendin me Bashkimin Evropian.

Shitën pronë me dokumente të falsifikuara, arrestohen katër persona për mashtrim mbi 1.5 milion euro

PRISHTINË, 24 SHKURT - Prokuroria Themelore në Prishtinë në bashkëpunim të ngushtë me Policinë e Kosovës ka arrestuar katër persona me inicialet M. M., S. B., D. R. dhe B. Z., të cilëve u është caktuar masa e ndalimit prej 48 orësh për shkak të dyshimit të bazuar se kanë kryer veprën penale: Mashtrimi në bashkëkryerje nga neni 323,

paragrafi 4, lidhur me paragrafin 1 dhe nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Po ashtu, i dyshuari M. M. dyshohet edhe për kryerjen e veprës penale Falsifikimi i dokumenteve nga neni 390, paragrafi 2, lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, ndërsa i dyshuari D. R. dyshohet edhe për veprën penale Legalizim i përmbajtjes

së rreme nga neni 395 paragrafi 1 dhe 2 të KPRK-së. Sipas dyshimeve, të pandehurit me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror për vete, duke fshehur faktet relevante dhe duke e vënë në lajthim të dëmtuarin H. M., në bashkëkryerje i kanë shkaktuar dëm matrial në vlerë prej 1 578 180.00 euro.

Prokurori i shtetit ka nxjerrë urdhër ndalesë të përkohshme për parcelat përkatëse, pasi ekziston dyshimi i bazuar se prona është shitur mbi bazën e dokumenteve të falsifikuara dhe është transferuar në mënyrë të kundërligjshme. Njëkohësisht, nga Gjykata është kërkuar lëshimi i urdhrit ndalues përfundimtar për këto parcela,



me qëllim të sigurimit të pronës deri në përfundim të procedurës penale. Ndërsa, gjykata kompetente ua ka caktuar të pandehurve M. M., S. B., D. R. dhe B. Z. masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej 30 ditësh.

KU DO T'I SHPENZOJË KOSOVA 4 MILIARDË EURO?

PRISHTINË, 24 SHKURT - Kuvendi i Kosovës e ka miratuar Ligjin për Buxhetin shtetëror në vlerë rreth 4 miliardë euro, me gjithë kundërshtimet dhe ankesat e opozitës. Projektligji për Buxhetin kaloi në lexim të dytë me 62 vota për, 36 kundër dhe asnjë abstenime, katër ditë pasi ishte miratuar në lexim të parë. Ligji tani do t'i dërgohet presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani, për dekretim, para se të hyjë në fuqi.

Votimi erdhi pasi Komisioni për Buxhet, Punë Dhe Transfere bëri ndryshime dhe i miratoi ato në ligjin për ndarjet buxhetore për vitin 2026.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha se vërejtjet dhe kritikën e deputetëve do të trajtohen me rastin e rishikimit të buxhetit për këtë vit. “Megjithatë, buxheti i miratuar sot, në vlerë prej rreth 4 miliardë euro, parasheh 867 milionë euro për komunat; përfshin pagën e 13 për punëtorët e sektorit publik; përmban ndryshimin e nevojshëm që mundëson dyfishimin e shtesës për përvojën e punës nga 0.25 për qind në 0.50 për qind për 15 vitet e para; si dhe shtyrjen e afatit për zbatimin e shkallës progresive të tatimit në pronë, derisa ta miratojmë Ligjin e ri për Tatimin në Pronë, në konsultim me komunat e vendit tonë”, kishte shkruar Kurti në “Facebook”.

Kurti shtoi se në buxhet, po ashtu, rritet mbështetja për

barnat esenciale, kulturën, sportin, për ndërmarrësit në sektorin privat, bujqit dhe parashihen investime në infrastrukturën publike.

Gjatë seancës plenare ministri i Financave, Hekuran Murati, tha se ky është një buxhet i “përkohshëm dhe emergjent”, duke shtuar se ai do të rishikohet. “Për këtë arsye, ne, si qeveri, nuk ua kemi dhënë hapësirën as ministrive që të bëjnë ndryshime, duke konsideruar se nuk kemi shumë kohë për t'i bërë ndryshimet e nevojshme dhe në mënyrë cilësore, në mënyrë që ato pastaj të mos reflektojnë me probleme gjatë rrugës”, tha Murati.

Partitë opozitare u ankuan se rekomandimet e tyre ishin shpërfillur nga Komisioni dhe i tërhoqën ato në prag të votimit në Kuvend, prandaj edhe votuan kundër kalimit të buxhetit vjetor. Deputetë të caktuar opozitarë paraqiten amendamente gjatë seancën, por nuk morën mbështetje.

Shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Arian Tahiri, e kritikoi projektligjin për buxhetin dhe njoftoi se deputetët nga partia e tij do të votonin kundër. “Ne i tërheqim të gjitha amendamentet dhe nuk e mbështesim këtë buxhet që nuk e reflekton as përbërjen e qeverisë, nuk është dokument profesional, ka shumë defekte për 2026, por do të jetë i dëmshëm edhe për vitet e ardhshme”, ka thënë ai në



seancë.

Shefja e grupit parlamentar nga Lidhja Demokratike e Kosovës, Jehona Lushaku, tha se partia e saj nuk ka votë “për” buxhetin, pasi që Komisioni për Buxhet nuk i mori parasysh amendamentet e propozuara nga ajo.

Buxheti i vitit 2026 u miratua me disa muaj vonesë, dhe pasi vendi ishte detyruar ta zgjaste buxhetin e vitit të kaluar për disa muaj për shkak të krizës politike e institucionale.

Si do të shpenzohet buxheti i vitit 2026?

Buxheti i vitit 2026 parashihet të arrijë në rreth 4 miliardë euro. Nga kjo shumë, mbi tre miliardë euro janë ndarë për nivelin qendror, ndërsa 867 milionë euro për nivelin lokal. Për investime kapitale, të cilat shihen si shtylla kryesore për zhvillimin ekonomik, janë planifikuar 998 milionë euro, ose 7.2 % më

shumë krahasuar me vitin 2025 (931 milionë euro). Megjithatë, investimet kapitale përbëjnë vetëm 25.2 % të buxhetit të përgjithshëm.

Në një analizë të Institutit GAP thuhet se 81 për qind e buxhetit të projekteve kapitale në vitin 2026 është për projektet që do të vazhdojnë nga vitet e kaluara, ndërsa projektet e reja mbeten të kufizuara si në numër ashtu edhe në vlerë dhe kryesisht janë projekte të vogla.

Shpërndarja e investimeve kapitale, sipas GAP-it, nga niveli qendror në komuna vazhdon të jetë joproporcionale me popullsinë dhe sipërfaqen, ndonëse më e balancuar nga aspekti partiak, duke nxjerrë në pah pabarazi.

Subvencionet dhe transferet

Kategoria me rritjen më të madhe është ajo e

subvencioneve dhe transfereve, me një rritje prej 17.4 %. Sivjet janë ndarë mbi 1.3 miliard euro krahasuar me rreth 1.1 miliard euro në vitin e kaluar. Kjo rritje vjen si rezultat i rritjes së disa kategorive të pensioneve, mbështetjes se lehonave dhe rritjes së asistencës sociale.

Pagat dhe shtesat për mbi 91 mijë punonjës të sektorit publik do të kushtojnë mbi 980 milionë euro, nga 916 milionë euro sa ishin në vitin 2025.

Ndërkohë, shpenzimet për mallra dhe shërbime arrijnë në 509 milionë euro, ose rreth 7 milionë euro më shumë se vitin e kaluar.

Në buxhet janë ndarë edhe 46 milionë euro si rezervë shtetërore për emergjencë, e njëjta shumë si në vitin paraprak, me qëllim ruajtjen e stabilitetit dhe likuiditetit financiar.

Për herë të parë projektbuxheti parasheh edhe pagën e 13 për punonjësit e sektorit publik, për ata që kanë qenë të angazhuar në organizata buxhetore të paktën 12 muaj para marrjes së vendimit.

E barrën kryesore për mbushjen e arkës së shtetit pritet ta mbajnë Dogana e Kosovës, nga e cila parashihet të grumbullohen mbi dy miliardë euro, dhe Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), me rreth 1.2 miliard euro të hyra të planifikuara.

ÇMIMET E PRODHIMIT PATËN NGRITJE NË VITIN 2025

PRISHTINË, 24 SHKURT - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar Indeksin e Çmimeve të Prodhimit (IÇP) për tremujorin e katërt (TM4) 2025. Indeksi i tërësishëm i çmimeve të prodhimit në Kosovë (IÇP) pati ngritje prej 0,1 % ndërmjet TM4 2025 dhe TM3 2025, kurse krahasuar TM4 me të njëjtën periudhë të vitit paraprak (TM4 2024) çmimet e prodhimit u ngritën në një mesatare prej 5,4 %.

Çmimet e prodhimit në Kosovë patën një ngritje prej 0,1 % ndërmjet TM4 2025 dhe TM3 2025. Ngritjet më të mëdha sipas degëve të veprimtarive ekonomike vërehen te: prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës (3,2 %); prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve p.k.t (2,3 %); prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës, përveç mobilie: prodhimi i artikujve nga kashta



dhe materialeve të gërshetuara -thurëse (2,1 %); shtypja dhe riprodhimi i medieve të incizuara (1,1 %); xeherorët dhe guroret e tjera (0,8 %); prodhimi i pijeve (0,4 %); energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajër të kondicionuar (0,2 %); prodhimi i produkteve minerale jometalike (0,2 %); prodhimi i tekstilit (0,2 %); nxjerrja e xehes së metalit (0,1 %); prodhimi i veshjeve (0,1 %); prodhimi i

produkteve kimike (0,1 %).

Ngritja u neutralizua nga rënia e çmimeve te: prodhimi i metaleve (-3,7 %); veprimtaritë e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbeturinave (-1,2 %); prodhimi tjetër p.k.t. (-1,1 %); prodhimi i mobilie (-0,3 %); prodhimi i produkteve të fabrikua metalike, përveç makinerisë dhe pajisjeve (-0,3 %); dhe përpunimi i produkteve ushqimore (0,7 %).

Tremujori i katërt 2025 - tremujori i katërt 2024 (5,4 %)

Çmimet e Prodhimit në Kosovë u ngritën në një mesatare prej 5,4 % ndërmjet TM4 2025 dhe TM4 2024. Ngritje më të mëdha sipas degëve të veprimtarive ekonomike vërehen te: energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajër të kondicionuar (20,9 %); prodhimi i mjeteve motorike (të transportit), rimorkiove dhe gjysmërimorkiove (9 %); prodhimi i veshjeve (8,6 %); përpunimi i produkteve dhe preparateve farmaceutike (8,1 %); prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve p.k.t (7,6 %); prodhimi tjetër p.k.t. (6,4 %); prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës (6,2 %); shtypja dhe riprodhimi i medieve të incizuara (5,9 %); prodhimi i pajisjeve elektrike (5 %); prodhimi i produkteve të

fabrikua metalike, përveç makinerisë dhe pajisjeve (3,7 %); prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës, përveç mobilie: prodhimi i artikujve nga kashta dhe materialeve të gërshetuara -thurëse (3,2 %); prodhimi i tekstilit (1,4 %); përpunimi i produkteve ushqimore (2,2 %); grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë (1,7 %); nxjerrja e xehes së metalit (0,7 %); prodhimi i produkteve minerale jometalike (0,6 %); prodhimi i produkteve kimike (0,2 %).

Ngritja u neutralizua nga ulja e çmimeve te: prodhimi i metaleve (-11,6 %); veprimtaritë e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbeturinave; rikuperimi i materialeve (-4,4 %); prodhimi i mobilie (-0,8 %); prodhimi i pijeve (-0,7 %); prodhimi i produkteve të gomës dhe të plastikës (-0,4 %); dhe xeherorët dhe guroret e tjera (-0,1 %).

A MUND TA MPOSHTIM VDEKJEN? SHKENCA, MILIARDERËT DHE LUFTA PËR PAVDEKËSI

Pavdekësia, ose iluzioni më i vjetër i njerëzimit. Shkenca po zbulon sekretet e plakjes, por jo shpëtimin nga vdekja. Ndërsa miliarderët investojnë miliarda për të sfiduar kohën, realiteti është më kompleks: ajo që mund të fitojmë nuk është përjetësia, por vitet e shëndetshme

A mund ta mposhtim vdekjen? A po përpiqet shkenca? Ja çfarë thonë studiuesit dhe pse miliarderët po investojnë miliarda për pavdekësinë.

Çelësi i një jete të gjatë nuk është aspak sekret: të hash dhe të flesh mirë, të bësh pak aktivitet fizik, të mos përfundosh nën rrotat e një autobusi dhe të shpresosh që sëmundjet e trashëguara të mos aktivizohen në gjenet e tua. Venkatraman Ramakrishnan, një vegjetarian që çdo ditë shkon me biçikletë në laboratorin e tij në Kembrixh, i bën të gjitha këto dhe, në moshën 72-vjeçare, thotë se e sheh vdekjen “me filozofi”.

Por ashtu si miliona njerëz në botë, edhe ai merr ilaçe kundër tensionit, kolesterolit dhe mpiksjes së gjakut.


Nëse në fund të jetës do t'i ofrohej një pilulë që nuk parandalon sëmundjen, por procesin e plakjes, dhe i jepte edhe dhjetë vite të tjera jetë, a do ta merrte?

“Do të tundoheshim të gjithë”, përgjigjet ai. “Dëshira për të jetuar më gjatë është thellësisht e rrënjësuar tek të gjithë ne”.

A mund të ekzistojë një ilaç i tillë? “Nuk besoj se ka ndonjë ligj shkencor që të vendos një kufi natyror rreth moshës 120-vjeçare, siç thuhet shpesh. Por të arrish një gjë të tillë është jashtëzakonisht e vështirë”.

A mund ta mposhtim vdekjen? Pyetjet që lindin

Pak njerëz dinë më shumë për jetën, dhe mekanizmat qelizorë që e drejtojnë, sesa Ramakrishnan. Biologu molekular fitoi Nobelin në vitin 2009 për studimin e strukturës së ribosomeve, organelat që lexojnë ADN-në dhe prodhojnë proteinat. Pas dhjetëra çmimeve dhe nderimeve, ai po e drejton tani vëmendjen tek fundi i jetës. Faraonët ndërtuan piramidat për të përgatitur udhëtimin në botën tjetër; perandorët kinezë u varrosën me ushtri prej argjile për të mbrojtur trupin deri në ringjallje. Rimishërimi hindu, parajsja dhe ferri kristian, kopshti i paqes së përjetshme në Islam, të gjitha lindën sepse, siç thotë Ramakrishnan, “ideja e vdekjes është aq e tmerrshme, sa jetojmë pjesën më të madhe të jetës duke e mohuar”. Titulli i librit të tij të ri, Why We Die, mjafton për t'i shkaktuar ankth një lexuesi. Me rënien e



ndikimit të fesë, në raportin tonë me vdekjen është krijuar një boshllëk. Në vend të priftërinjve, gjithnjë e më shpesh kthehemi drejt një grupi njerëzish, zakonisht burra të moshuar, të bardhë, perëndimorë dhe ultra të pasur, që Ramakrishnan i quan “tregtarët e pavdekësisë”.

Miliarderët që kërkojnë jetë të pafund

Ramakrishnan u rrit në Vadodara, Indi, në një familje shkencëtarësh hindu dhe me një edukim kryesisht laik. Punon prej 25 vitesh në Laboratorin e Biologjisë Molekulare të Këshillit të Kërkimeve Mjekësore në Kembrixh. Vetëm disa milje larg është një prej qendrave të Altos Labs, startup-i bioteknologjik më i financuar ndonjëherë (3 miliardë dollarë), mbështetur nga Jeff Bezos dhe miliarderit Yuri Milner. Qëllimi? Të ndalojë plotësisht procesin e plakjes. Dhe nuk është e vetmja: më shumë se 700 kompani të tjera kanë ambicie të ngjashme. Iniciativa Chan-Zuckerberg, e Mark Zuckerbergut dhe bashkëshortes së tij, premton madje “të kurojë, parandalojë ose menaxhojë çdo sëmundje brenda këtij shekulli”.

A është kjo një kështjellë në ajër, apo thjesht mashtrim? “Këta miliarderë të teknologjisë shpesh kanë pasur sukses që në moshë të re”, thotë Ramakrishnan. “Ata e shohin jetën si një kod kompjuterik që mund të ‘hacker-ohet’. Por plakja është shumë më komplekse”.

Megjithatë, jo çdo ide është e pavlefshme. “Në 50 vitet e fundit biologjia molekulare ka bërë hapa gjigante në kuptimin e procesit të plakjes”.

A mund të mbetemi të rinj?

Çfarë dimë realisht për plakjen qelizore? Nëse lëmë mënjane sëmundjet dhe aksidentet, plakja çon në vdekje. “Mund ta përfytyrosh si një grumbullim dëmtimesh në qeliza dhe në aftësinë e tyre për t'u rigjeneruar”, thotë ai. Qelizat rinore rigjenerohen natyrshëm. Qelizat seneshente pushojnë së ndari dhe mbledhin dëmtime. Në fillim nuk është problem, mund të humbasësh edhe një gjymtyrë dhe të mbijetosh. Por në fund, sistemi dështon. Ramakrishnan citon Heminguejin: “Dështova në dy mënyra. Fillimisht gradualisht, pastaj papritur”. Po kështu edhe trupi: plaket ngadalë, vdes

papritur. Shkenca po përpiqet të kuptojë cila pjesë e këtij procesi është plakje dhe cila është sëmundje, dhe pikërisht aty mund të ndodhë përparimi i madh.

Të çmendurit, misionarët dhe realistët

Ramakrishnan i ndan të pasurit që ndjekin pavdekësinë në tre grupe:

1. Të çmendurit

Ata që besojnë tek ngrirja e trupit (kriogjenia) me shpresën se një ditë teknologjia do t'i ringjallë. “Nuk ka asnjë provë se kjo do të funksionojë ndonjëherë”. Një variant tjetër është “ngarkimi” i trurit në një arkiv dixhital për t'u “shkarkuar” më vonë në një formë tjetër jete. Sam Altman (OpenAI) është në listë pritjeje për këtë procedurë.

2. Misionarët

Njohin pak biologji dhe mendojnë se mund ta zgjasin jetën. Shembulli i famshëm është Bryan Johnson, i cili u bë titull lajmesh kur i mori të birit transfuzion plazme, frymëzuar nga eksperimente të parabiozës tek kafshët. Rezultatet? Pothuajse asnjë ndryshim. Tani po ndjek rrugën e telomerëve, e


cila mund të ndihmojë, por mund të rrisë edhe rrezikun e tumoreve.

3. Realistët

Këtu e vendos veten Ramakrishnan. Ata nuk kërkojnë pavdekësi, por zgjatjen e viteve të shëndetshme duke luftuar sëmundjet. “Shumica e sëmundjeve rriten me moshën. Nëse plakja është faktori kryesor, duhet të trajtojmë plakjen për të jetuar më gjatë dhe më mirë”.

Jetë më e gjatë, por jo pafundësisht

Ramakrishnan nuk është i interesuar për pavdekësinë. Synimi i tij është më tokësor: më shumë vite të shëndetshme për më shumë njerëz. A do të donte vetë t'i zgjaste vitet e karrierës së tij përmes shkencës së plakjes? “Jetojmë mjaftueshëm”, thotë. Rreziku i një jetegjatësie të tepruar, sipas tij, është një shoqëri e ngrirë, ku të moshuarit mbajnë pushtetin dhe pasuritë deri në pafundësi. “Vitin tjetër dal në pension. Jam ende mirë. Por një 35-vjeçar mund të krijojë një fushë krejt të re. Ka një ndjenjë të drejtësisë ndërbreznore. Jetojmë dyfish më gjatë se paraardhësit tanë”. / bota.al



Silva - Richards i Ferizajt, "Ylli i Javës" në Superligë

PRISHTINË, 24 SHKURT - Federata e Futbollit e Kosovës (FFK) në bashkëpunim me sponsorin zyrtar të Superligës, Albi Mall, vazhdon ta japin çmimin tradicional "Ylli i Javës", i cili i dedikohet futbollistit më të dalluar të javës në Superligën e futbollit të Kosovës. Për javën e 21-të të këtij edicioni ky çmim i është dhënë futbollistit të FC Ferizaj,

Ruben Silva Richards, i cili ia ka sjellë skuadrës 3 pikë me shënimin e dy golave kundër FC Ballkanit, ndërsa ndeshja përfundoi me rezultat 2:1. Vlerësimi është bërë nga Komisioni i Veteranëve të Futbollit. Pasi ka marrë këtë çmim, Richards është shprehur i lumtur që është vlerësuar lojtari më i mirë i javës. "Mendoj se ka qenë një ndeshje e mirë, një ndeshje

normale, ku ekipi funksionoi mirë mes vete. Unë shënova dy gola, por pa përpjekjen e madhe të futbollistëve të tjerë nuk do të ishte e mundur, andaj jam shumë mirënjohës. Është një ligë shumë e mirë, me lojtarë taktikë, me kualitet shumë të mirë dhe qyteti e shteti i Kosovës janë shumë të mira. Bashkëlojtarët më kanë pritur shumë mirë dhe gjithçka është shumë bukur

këtu. Jam shumë mirënjohës. I kam shënuar dy gola, gjithashtu janë futbollistët e tjerë në ekip të cilët po kalonin javë të vështira dhe mendoj personalisht që është një tjetër futbollist që ka bërë shumë mirë në këtë ndeshje. Ai është kapiteni i ndeshjes, Mexhit Neziri, të cilit ia dedikoj këtë shpërblim", ka thënë ai për faqen zyrtare të FFK-së.

'DARDANET' GATI PËR NDESHJET KUALIFIKUESE

PRISHTINË, 24 SHKURT - Përzgjedhësi i Kombëtares së Kosovës për vajza, Sami Sermahaj, e ka publikuar listën e futbollisteve të ftuara për dy ndeshjet e para të edicionit të ri të kualifikimeve për Kupën e Botës 2027. "Dardanet" do të përballen me Gjibraltarin dhe Kroacinë në fillim të muajit marsit në kuadër të Grupit 2 në Ligën C, ka njoftuar Federata e Futbollit e Kosovës.

Selektori Sermahaj ka ftuar 23 lojtare për këto ndeshje që vlerësohen të rëndësishme, ndërsa grumbullimi i "Dardaneve" nis këtë javë. Ndeshjen e parë Kosova e luan në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë kundër Gjibraltarit më 3 mars, ndërsa katër ditë më vonë do të përballen në udhëtim me Kroacinë, saktësisht në Karlovac. Kosova bën pjesë në Grupin

C2, ku krahas Kroacisë dhe Gjibraltarit, këtë grup e përbën edhe Bullgaria. Fituesi i grupit kalon në "play-off" për kualifikim në Botëror, njëkohësisht promovohet në Ligën B për ciklin e ardhshëm të Ligës së Kombeve. Përveç fituesit të grupit, në "play-off" për Botëror do të kualifikohen edhe dy skuadrat më të mira që renditen të dyta, nga gjashtë grupet e Ligës C.



LOJËRAT MESDHETARE NË KOSOVË SJELLIN RISI

PRISHTINË, 24 SHKURT - Lojërat Mesdhetare "Prishtina 2030" (edicioni i 21-të) do të kenë një program të zgjeruar me 24 sporte konkurruese, duke përfshirë sporte klasike të Olimpikut si atletikë, not, xhudo, boks, volejbol dhe sporte të tjera si basketboll 3x3, futsal (i zëvendësion futbollin tradicional U21) dhe mundësinë për të shtuar edhe sporte si Baseball5, Canoe Sprint apo Kickboxing në varësi të aprovimit të fundit të organizatorëve. Kjo e bën programin mjaft më dinamik dhe më gjithëpërfshirës se në edicionet e mëparshme.



Për ta përgatitur mbajtjen e lojërave janë planifikuar investime të mëdha në infrastrukturë sportive në

Kosovë. Kjo përfshin ndërtimin e një stadiumi kombëtar modern që do të jetë vendi i ceremonive hapëse dhe

mbyllëse, si dhe objekte të reja të sportit në disa qytete (p.sh. Pejë, Ferizaj, Prizren e Vushtrri). Janë gjithashtu plane për pallate të sporteve, pishina gjysmolimpike dhe përmirësime të objekteve ekzistuese. Një nga elementet e rëndësishme të përgatitjeve është transformimi i Qendrës së Studentëve në Prishtinë në një qendër të akomodimit për mijëra atletë, me rreth 4 500 shtretër dhe ambiente të reja, si dhe rinovime të kuzhinës dhe objekteve të tjera të shërbimit. Ky është një investim afatgjatë që do të shfrytëzohet edhe pasi

përfundojnë lojërat. Ngaqë Kosova s'ka dalje në det, për sportet si vela dhe gara me varkë apo sporte ujore të lidhura me detin, vendi ka bërë marrëveshje bashkëpunimi me Shqipërinë, ku eventet në det do të zhvillohen në bregdet, një nismë unike që është risia historike e këtij edicioni të Lojërave Mesdhetare. Në edicionin e vitit 2030 pritet të marrin pjesë rreth 3 500 deri në 5 000 atletë nga 26 vende të rajonit mesdhetar, duke e bërë këtë ngjarjen sportive më të madhe që Kosova ka organizuar ndonjëherë.

Martinez: Ronaldo është më i madhi në histori, nëse fiton Kupën e Botës apo jo

LISBONË, 24 SHKURT - Përzgjedhësi i Portugalisë, Roberto Martinez, ka deklaruar se kapiteni Cristiano Ronaldo meriton më shumë respekt dhe është futbollisti më i madh i të gjitha kohëve (GOAT) pavarësisht nëse do ta fitojë Kupën e Botës këtë verë. Martinez ka theksuar rëndësinë e trashëgimisë së Ronaldos, duke e cilësuar lojtarin më të madh ndonjëherë. "Ai do të jetë lojtari më i madh ndonjëherë,

pavarësisht nëse fiton Botërorin apo jo. Përgjegjësia jonë është t'i japim vetes shansin më të mirë për të konkurruar për të. Kjo vjen nga analiza, përmirësimi i vazhdueshëm dhe ruajtja e të njëjtit mendim që na ndihmoi të kemi sukses në Ligën e Kombeve", ka thënë ai. Spanjollit ka folur edhe për përvojën e punës direkte me Ronaldon dhe përkushtimin e tij. "Nuk kam punuar kurrë me

një lojtar që çdo mëngjes ka këtë fokus për të përdorur ditën për t'u përmirësuar. Nëse do të mund të kishim Cristiano përgjithmonë, kjo do të ishte mënyra më e lehtë për t'i ndihmuar lojtarët e rinj kur arrijnë në ekipin kombëtar. Dëshira e tij është të përdorë çdo ditë për t'u bërë më i mirë", ja thënë Martinez, duke shpjeguar se Ronaldo vazhdon të vendosë standarde për lojtarët në mbarë botën edhe

në moshën e tij 40-vjeçare. "Mendoj se duhet ta pranojmë që të gjithë në botë e njohin Cristiano Ronaldon dhe kanë një opinion për të. Por, Cristiano Ronaldo që iu bashkua kombëtares 21 vjet më parë nuk është i njëjti Cristiano që është tani. Ai është shumë më shumë një lojtar pozicional, një sulmues. Ai është një lojtar që, për ne, është një përfundues aksionesh. Ai është golashënuesi më i madh i të



gjitha kohëve. Pra, të kesh një lojtar që tani ka 25 gola në 30 ndeshjet e fundit për kombëtaren është një dhuratë", ka thënë Martinez.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, “Kastrioti OP”, Carralevë, Komuna e Shtimes, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, për eksploatimin, thërrmimin dhe seperimin e gëlqerorit në vendburim Shushubrad, Carralevë, Shtime.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 14.04.2026 në ora 10:00 në Sh.F.M.U. “Abdullah Shabani”, Rr. Milaim Beha, pn, Carralevë, Shtime, do të organizohet debat publik nga Kompania “Kastrioti OP”, Carralevë, Shtime në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

<https://us04web.zoom.us/j/5289487423?pwd=atEPUrNDxCwMcX5GSCHJS7NmAu7JDN.1>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë “Kastrioti OP”, Carralevë, Shtime, për Pëlqim Mjedisor, për eksploatimin, thërrmimin dhe seperimin e gëlqerorit në vendburim Shushubrad, Carralevë, Shtime.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin

vnk.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

OBAVEŠTAVAMO

Našeg suvlasnika sa suvlasničkim deom **1/14 REIMKA (Bajram) SADIKI**, kao zainteresovanog kupca da mi kao suvlasnici na parceli : **P-71813063-00289-3 ZK Petrovo Selo Opština Prizren** sa suvlasničkim delovima : , Sadiki (Bajram) Asim **1/8** , Sadiki (Bajram) Safeta **1/14** , Redza (Bajram) Fatime **1/14** , Sadiki (Bajram) Veljija **1/8** , Sadiki (Bajram) Atima **1/8** , Sadiki (Bajram) Jasmina **1/14** , Sadiki (Bajram) Asima **1/14** , Sadiki (Bajram) Xhelil **1/14** , Sadiki (Bajram) Ramadan **1/8** , Krasniqi (Bajram) Mida **1/14** prodajemo u celosti naše suvlasničke delove .

Ovim putem nudimo suvlasniku ukoliko je zainteresovana za kupovini da se javi u roku od 30platiti svezkupnu cenu **kupoprodajnu cenu od , 225.000 €** I to načinom uplate u gotovini / odjednom .

Kontakt Telefon : 045473300



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Veprim Deva B.I. shpall të pavlefshme numrin Unik Identifikues 811146095 të lëshuar nga MTI e Kosovës.

- Asllan Babaj shpall te pavlefshme dëftesat e vitit I,II,III dhe diplomën e shkollës së mesme të lartë të gjimnazit “Frang Bardhi”.

- Doni ES Sh.p.k. shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me numër unik identifikues 811273507.

- Florentina Trepça shpall te pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të lartë “Dr, Xheladin Deda”.

- Sami Mustafa shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Fehmi Rama” ish shkolla fillore “Emin Duraku” Likoc Skenderaj.

- Hysen Ferizi shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Azem Bejta” Prekaz i Eperm Skenderaj.

- Rrustem Tahiri shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Trepça” Stanterg.

- Drita Zabeli shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Malush Ahmeti” ish shkolla “Muharrem Bekteshi” Rezalle Skenderaj.

Milaim Sh. Hajdari shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Teknike mekanik i radiotelevizionit të shkollës “Gjin Gazulli” Prishtinë.

Kujtim Hakaj shpall të pavlefshme diplomën e sh, profesionale “Dituria” Prizren.

Tahir Neziri shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Kuvendi i Juniku” Junik.

Zejnije Morina shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Xhelal Hajda Toni” Ratkoc Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

